

LIGJ
Nr.7569, datë 27.5.1992

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7524, DATË 19.11.1991 "PËR STATUSIN E
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR"**

Në mbështetje të neneve 16 e 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr.7524, datë 19.11.1991 "Për Statusin e Radiotelevizionit Shqiptar", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8, paragrafi i parë formulohet si vijon:
"Këshilli Drejtues i RTSH është organ vendimor. Ai përbëhet nga 11 vetë. Në këtë këshill bën pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i RTSH".

Neni 2

Në nenin 9, paragrafi i pestë, pas fjalës "miraton" shtohen fjalët "emërimin dhe shkarkimin".

Neni 3

Në neni 11, paragrafi i tretë, në rrjeshtin e fundit, neni "8" bëhet neni "9".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.229, datë 22.6.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha